



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
KOMUNËS SË GJILANIT
PËR VITIN 2019**

Prishtinë, qershor 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjilanit në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Naser Arllati, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i ekipit Pleurat Isufi, Milosh Petrovic dhe Gazmend Namani (anëtarë), nën menaxhimin e Drejtorit të Departamentit të Auditimit Astrit Bllaca.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli.....	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve	26
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	32
Shtojca II: Letër e Konfirmimit	35

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Komunës së Gjilanit për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzione

Pasqyrat financiare vjetore ishin përgatitur në harmoni me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, përveç disa gabimeve jo materiale që ndërlidhen me keqklasifikimin e shpenzimeve.

Kontrollet mbi shpenzimet kërkojnë përmirësime të mëtejme, veçanërisht në fushën e prokurimit ku nuk kishte një proces të mirëfilltë në vlerësim të kontratave. Dobësi evidente janë vërejtur edhe në fusha tjera të rëndësishme financiare, përfshirë shpenzimet, obligimet si dhe pasuritë.

Përgjigja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak tregon që prej 18 rekomandimeve të dhëna, 10 ishin zbatuar, një ishte në proces, katër nuk janë zbatuar dhe tri rekomandime janë konsideruar si të mbyllura.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar.

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Komunës së Gjilanit, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve së Komunës së Gjiçanit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP), sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Komuna. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Gjilanit kishte shpenzuar 94% të buxhetit final për vitin 2019, që nënkupton një realizim të mirë në nivel të përgjithshëm. Kontrollët mbi shpenzimet kërkojnë përmirësime të mëtejme, veçanërisht në fushën e prokurimit ku nuk kishte një proces të mirëfilltë në vlerësim të kontratave. Dobësi evidente janë vërejtur edhe në fusha tjera të rëndësishme financiare, përfshirë shpenzimet, obligimet si dhe pasuritë.

Rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet procesit të prokurimit gjatë vlerësimit të kontratave, keqklasifikimit të shpenzimeve, regjistrimin e pasurisë jo financiare, futjen në përdorim të programit E-pasuria dhe ndërmarrjen e veprimeve në zvogëlimin e obligimeve dhe shpalosjet e tyre të sakta në PFV.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	25,544,787	27,146,780	25,499,227	94	24,353,251	21,945,524
Granti i Qeverisë – Buxheti	20,862,476	20,862,476	20,349,084	98	19,693,440	17,522,089
Të bartura nga viti paraprak ³ –	-	1,091,964	1,042,842	96	956,796	1,203,985
Të hyrat vetjake ⁴	4,465,884	4,465,884	3,880,386	87	3,213,264	3,078,570
Donacionet e brendshme	-	56,045	55,603	99	50,532	3,152
Donacionet e jashtme	-	670,411	171,312	26	439,219	137,728
Financimi nga Huamarrja	216,427	-	-	-	-	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,601,993€. Kjo rritje është rezultat i bartjes së të hyrave vetjake nga viti paraprak si dhe donacioneve të jashtme dhe donacioneve të brendshme.

Në vitin 2019, komuna ka shpenzuar 94% të buxhetit final ose 25,499,227€, me një përmirësim prej 2% krahasuar me vitin 2018. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	25,544,787	27,146,780	25,499,227	94	24,353,251	21,945,524
Pagat dhe Mëditjet	15,472,123	15,529,766	14,958,556	96	14,883,094	14,394,998
Mallrat dhe Shërbimet	3,710,000	3,868,059	3,722,837	96	3,205,411	2,653,764
Shërbimet komunale	671,500	671,500	515,225	77	684,100	496,834
Subvencionet dhe Transferet	608,936	1,082,486	775,550	72	778,398	536,720
Investimet Kapitale	5,082,228	5,994,969	5,527,059	92	4,802,248	3,863,208

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Buxheti final për paga ishte rritur për 57,643€. Kjo rritje vjen nga të hyrat e bartura në vlerë 10,000€ dhe nga donacionet në vlerë 47,643€;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 158,059€. Buxheti ishte rritur nga të hyrat e bartura në vlerë 230,000€ dhe nga donacionet në vlerë 144,486€. Ndërsa buxheti ishte zvogëluar në vlerë 216,427€, për mjetet e financimit nga huamarrja të cilat ishin transferuar në Ministrinë e Shëndetësisë;
- Buxheti final për kategorinë e subvencioneve ishte rritur për 473,550€. Kjo rritje vjen nga të hyrat e bartura në vlerë 52,000€ dhe nga donacionet në vlerë 421,550€; dhe
- Buxheti final për shpenzime kapitale ishte rritur për 912,741€. Buxheti ishte rritur nga të hyrat e bartura në vlerë 799,964€ dhe nga donacionet në vlerë 112,777€.

Çështja A1 – Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike**Gjetja**

Sipas nenit 18, pika 3 e rregullores 01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Komuna kishte kryer pagesa nga kategoritë e gabuara në vlerë 176,912€, si:

- Nga kategoria e investimeve kapitale janë paguar 3,000€ që i takojnë kategorisë mallrave dhe shërbimeve, ato kanë të bëjnë me dhënien e shpërblimit për një konkurs projektues.
- Vlera 160,630€ është paguar për shpenzime të varrimit nga kategoria mallra dhe shërbime e në fakt i takojnë kategorisë së subvencioneve;
- Pagesat për paga për punonjës të arsimit ishin paguar përmes vendimeve gjyqësore nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në vlerë 10,315€; dhe
- Në një rast për sindikatën e Policisë, ishin dhënë mjete për përkrahjen e një aktiviteti sportiv, në vlerë 2,967€, nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve e do duhej të ishin nga kategoria e subvencioneve.

Nuk kemi marrë ndonjë sqarim nga ana e zyrtarëve komunal, në lidhje me këto keqklasifikime.

Ndikimi

Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, shpien në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare të Komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe si të tilla japin informata çorientuese për shfrytëzuesit e PFV-e.

Rekomandimi A1 Kryetari i duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që të shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestitim të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna në 2019 ishin në vlerë 3,765,119€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

Tabela 3. Të hyrat(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	% e pranimeve 2019	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Totali i të Hyrave	4,465,885	4,465,885	3,765,119	84	3,360,094	3,672,615
Të hyrat tatimore	1,435,000	1,435,000	1,651,324	115	1,412,110	1,437,760
Të hyrat jo tatimore	3,030,885	3,030,885	2,113,795	70	1,947,984	2,234,855

Komuna kishte edhe të hyra indirekte në vlerë prej 815,395€. Të hyrat indirekte përbëhen prej të hyrave nga gjobat e Policisë 744,645€, të hyrat nga gjobat e Gjykatës 52,260€ dhe të hyrat nga Agjencia e Pyjeve 18,490€. Ne kemi testuar 38 mostra për teste substanciale në vlerë prej 421,810€, si dhe 15 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B1 - Dhënia me qira e pronës komunale pa i respektuar procedurat

Gjetja Sipas ligjit 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale, neni 8 përcakton se dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës bëhet përmes procedurave të: ankandit publik; shprehjes së interesit; negociatave të Kryetarit të Komunës.

Komuna kishte nënshkruar marrëveshje në vlerë 1,667€ në muaj me një kompani me datë 29.04.2009, e cila ishte vazhduar me 01.07.2014. Komuna nuk i ka zbatuar plotësisht kërkesat e dala nga ligji 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale. Zyrtarët nuk kanë ofruar ndonjë shpjegim për mos zbatim të kërkesës ligjore.

Ndikimi Mos respektimi i procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe mbikëqyrjen e pronës komunale, i ka pamundësuar komunës që të arrijë çmimin më të lartë për dhënien në shfrytëzim të kësaj prone.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurohet që prona e paluajtshme e komunës të shfrytëzohet në mënyrë efektive duke pasur parasysh respektimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për vitin 2019 është 15,529,766€, prej tyre ishin shpenzuar 14,958,556€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 2,459 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 2,343. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 56 punonjës të rinj (18 në Njësinë e personelit, 36 Drejtorinë e Arsimit dhe dy në Administratën e Shëndetësisë). Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 305,105€, si dhe 20 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B2 - Kompensimi i pagave jo në pajtim me Aktet e Emërimit

Gjetja Edhe këtë vit, Komuna ka vazhduar me kompensimin e tre shërbyesve civil jo në pajtim me Akt Emërimet.

- Përgjegjësi në sektorin e katalogimit dhe klasifikimit të librit, sipas kontratës duhet të paguhet me koeficient 7, por sipas listës së pagave paguhet me koeficient 6. Ndryshimi i koeficientit në kontratë nga 6 në 7 është bërë më 01/02/2012 dhe nuk është zbatuar;
- Shefi i Sektori për Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit, me Akt Emërim duhet të paguhet me koeficient 9, por sipas listës së pagave ai paguhet me koeficient 7.5. Ndryshimi i koeficientit nga 7.5 në 9 në kontratë është bërë më 01/02/2013 por nuk është zbatuar; dhe
- Përgjegjësi në Sektorin Fëmijëve dhe të Rinjve, me Akt Emërim duhet të paguhet me koeficient 7, por sipas listës së pagave, paguhet me koeficient 6. Ndryshimi i koeficientit nga 6 në 7 është bërë më 01/02/2012.

Sipas komunës kjo ka ndodhur për shkak të gradimit në vitet e mëhershme dhe ndryshimi apo rritja e koeficienteve është bërë pa u siguruar se Komuna kishte mundësi financiare apo duke mos marr parasysh ndikimin financiar për këto pozita. Komuna nuk ka ofruar dëshmi për komunikimet me Thesarin në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij rekomandimi.

Ndikimi Pagesa e punonjësve në kundërshtim me akt emërimet / kontratat e punës përveç që është shkelje ligjore, ekspozon komunën ndaj padive gjyqësore që mund shkaktojnë shpenzime shtesë për Komunën.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet që të planifikojë buxhet të mjaftueshëm dhe në bashkëpunim me Thesarin të filloj pagesat e pagave sipas kontratave të nënshkruara.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për Mallra dhe Shërbime si dhe Shërbime Komunale në vitin 2019 ishte 4,539,558€, prej tyre ishin shpenzuar 4,238,062€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me blerje të materialeve, furnizim për zyre, qira, lëndë djegëse, riparime dhe mirëmbajtje etj. Kemi testuar 51 mostra për teste substanciale në vlerë 754,179€ si dhe gjashtë mostra për teste të pajtueshmërisë.

2.1.4 Subvencionet dhe Transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,082,486€, prej tyre ishin shpenzuar 755,550€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me pagesa për përfitues individual, subvencione për entitete publike, etj. Kemi testuar nëntë mostra për teste substanciale në vlerë 134,979€ si dhe gjashtë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A2 - Mos përgatitja planit vjetor për mbështetje financiare për OJQ

Gjetja Rregullorja e MF – Nr. – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik Të OJQ-ve, Neni 6.1 përcakton se “Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës”.

Komuna nuk e kishte përgatitur Planin Vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve. Arsyeimi i vetëm nga zyrtarët e Komunës ka qenë që ne nuk e përgatisim një plan të tillë.

Ndikimi Mos përgatitja e planit vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve, paraqet mungesë të informatave së cilat fusha do përkrahën nga Komuna, si dhe qëllimet se për çfarë janë të parapara këto mjete.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se përgatitet Plani Vjetor për Mbështetje Financiare për OJQ-të dhe të sigurojë se i njëjti përmban të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregullore për Mbështetje Financiare.

Çështja A3 - Dhënia e subvencioneve për përfituesit e njëjtë**Gjetja**

Rregullorja e Subvencioneve e Komunës së Gjilanit Neni 6.2 përcakton se personi fizik apo juridik vetëm një herë në vit mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga Komuna.

Gjatë analizës së gjashtë subvencioneve të dhëna nga Komuna e Gjilanit, në tri prej tyre të dhëna për “Furnizim të bletarëve me shtëpiza tre-katëshe të tipit L&R”, “Ngritjen e 15 hektarëve me kulturën e arrës” dhe për “Mekanizma Bujqësor”, kemi gjetur se një numër i fermerëve ishin përfitues të dy e më shumë subvencioneve. Sipas Drejtorisë për Bujqësi, arsyeja pse personat e njëjtë kanë përfituar më shumë se një herë subvencione është sepse disa prej tyre janë të vogla për nga vlera, kështu që nuk është parë e arsyeshme të eliminohen përfituesit e njëjtë.

Ndikimi

Dhënia e shumëfishtë e subvencioneve për përfituesit e njëjtë duke i privuar të tjerët përfitues madje edhe nga përfitimi i njëhershëm, përveç që shfaq dyshime mbi korrektësinë e dhënieve të subvencioneve, gjithashtu ndikon në dëmtimin imazhit të Komunës dhe dekurajon fermerët për të aplikuar për subvencione në të ardhmen.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë se subvencionet do të jepen në pajtim me Rregulloren e Komunës, ku një fermer nuk mund të jetë përfitues më shumë se një herë brenda vitit. Përndryshe të shqyrtohet mundësia e ndryshim-plotësimit të rregullores për dhënie të subvencioneve.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,994,969€, prej tyre ishin shpenzuar 5,527,059€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve, ndërtimin e objekteve administrativo afariste, mirëmbajtje investive, blerjen e automjeteve etj. Kemi testuar 63 mostra për teste substanciale në vlerë 1,673,528€, dhe pesë mostra për pajtueshmëri.

Çështja A4 – Shpërblimi me kontratë pa i plotësuar kërkesat administrative të dosjes së tenderëve**Gjetja**

Sipas Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP) neni 41.1: Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga OE do të ekzaminohen, vlerësohen, krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do t'i jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë.

Tek procedura e prokurimit “Vërbicë e Zhegovcit – Sillovi” në vlerë 1,346,909€ kërkesë e dosjes së tenderit ishte që operatorët ekonomik të kenë ekskavator të kapacitetit 04-1m³ dhe 3-4m³, si dhe operatori ekonomik duhet të posedojë dy grejder minimum 12 ton. Operatori ekonomik fitues nuk kishte ofruar dëshmi se i plotëson këto kërkesa të dosjes së tenderit.

Tek procedura e prokurimit “Ndërtimi i rrugës së Kumanovës faza e II” në vlerë 2,388,853€, kërkesë e dosjes së tenderit ishte që operatorët ekonomik të kenë ekskavator të kapacitetit 04-1m³ dhe 3-4m³, të kenë çekiç pneumatik, dhe një inxhinier apo bachelor të hidroteknikës me përvojë profesionale minimum 2 vite pas diplomimit në realizimin e projekteve të ngjashme dhe të caktohet me shkresë dhe të jetë nënshkruar nga inxhinieri dhe kompania. Operatori ekonomik fitues nuk kishte ofruar dëshmi se i plotëson këto kërkesa të dosjes së tenderit, dhe as dëshmi për kualifikimin dhe përvojën profesionale të inxhinierit të hidroteknikës.

Tek procedura “Asfaltimi i rrugëve në Livoçin e Ulët” në vlerë 466,026€, kërkesë e dosjes së tenderit ishte që operatorët ekonomik të kenë ekskavator të kapacitetit 04-1m³ dhe 3-4m³, të posedojë grejder minimum 12 ton, dhe të kenë çekiç pneumatik. Operatori ekonomik fitues nuk kishte ofruar dëshmi se i plotëson këto kërkesa të dosjes së tenderit.

Tek procedura “Hapja e rrugëve sipas planeve rregulluese” në vlerë 377,477€, kërkesë e dosjes së tenderit ishte që operatorët ekonomik të kenë ekskavator të kapacitetit 04-1m³, dhe që kontratat e nënshkruara ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit të jenë kopje e noterizuar dhe noterizimi të behët në prezencë të dy palëve tek noteri. OE fitues nuk kishte dëshmuar se posedon mekanizmin sipas dosjes së tenderit, dhe për shtatë punonjësit kontratën e punës me kompani e kishte dërguar tek noteri dikush tjetër e jo vet punonjësit, dhe të njëjtat nuk ishin noterizuar në prezencë të dyja palëve tek noteri.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve dhe njohurive të kërkesave specifike të dosjes së tenderit nga komisionet e vlerësimit. Nuk na janë dhënë arsye për këto të gjetura nga ana e zyrtarëve komunal.

Ndikimi Shpërblimi me kontratë i operatorëve ekonomik të cilët mund të mos i plotësojnë kërkesat dosjes së tenderit, mund të ndikojë që të njëjtit të mos mund t'i përfundojnë punët siç kërkohet pasi që nuk kanë arritur të dëshmojnë se posedojnë pajisjet e kërkuar sipas specifikave të dosjes së tenderëve.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë që me rastin e vlerësimit të krijohen kapacitete të mjaftueshme teknike të vlerësimit dhe të shpërblehen operatorët ekonomik të cilët i plotësojnë më së miri kërkesat e dosjes së tenderit.

Çështja A5 - Mungesa e menaxherëve të projektit

Gjetja RRUOPP neni 61.4, përcakton se pas nënshkrimit të kontratës nga të dy palët, Zyrtari përgjegjës i Prokurimit do ta informojë Zyrtarin Kryesor Administrativ "ZKA" dhe ZKA me shkrim do ta emërojë një Menaxher të Projektit përgjegjës për menaxhimin (mbikëqyrjen) e kontratës specifike dhe për ta informuar Zyrtarin përgjegjës të Prokurimit.

Në tri raste të testuara të procedurave të prokurimit për investimet kapitale, Komuna nuk kishte emëruar menaxher të projektit siç kërkohet me Rregullore. Sipas zyrtarëve komunal kjo është bërë për arsye se Komuna ka të lidhur një kontratë me një kompani private për mbikëqyrjen e punëve të cilat i ekzekuton Komuna.

Ndikimi Mos emërimi i menaxherëve të projekteve, ka si pasojë mungesën e duhur të komunikimit mes komunës dhe operatorëve ekonomik, si dhe mungon siguria se punët e kërkuara janë ekzekutuar sipas kushteve të kontratës.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë se për çdo kontratë të nënshkruar të emërohet menaxheri i projektit, pavarësisht faktit se Komuna ka organ mbikëqyrës.

Çështja A6 - Ndarje jo e duhur e detyrave në procesin e prokurimit

- Gjetja** Sipas nenit 62.7 të RRUOPP një anëtar i komisionit të vlerësimit nuk mund të emërohet si menaxher i projektit, mirëpo në rast të ri-vlerësimit, anëtarët e komisionit të kaluar të vlerësimit mund të shërbejnë si Menaxher të projektit.
- Kryetari i komisionit për vlerësimin e ofertave të tenderit “Hapja e rrugëve sipas planeve rregulluese”, ishte caktuar edhe menaxher i projektit për këtë kontratë. Sipas komunës kjo kishte ndodhur në mungesë të njohurive për kërkesat e rregullores që shmangin konfliktin e interesit.
- Ndikimi** Ndarja jo e duhur e detyrave, respektivisht angazhimi i zyrtarëve të njëjtë në vlerësimin e ofertave dhe në menaxhimin e projektit është në kundërshtim me rregullat e aplikueshme dhe rritë rrezikun e konfliktit të interesit.
- Rekomandimi A6** Kryetari duhet të sigurojë se aplikohen të gjitha procedurat dhe rregullat e prokurimit publik, sa i përket ndarjes së drejtë të detyrave gjatë procesit të prokurimit, për shmangien e çfarëdo konfliktit të mundshëm të interesit.

Çështja B3 - Tejkalim i sasive të kontraktuara**Gjetja**

Sipas RRUOP te neni 56.10 përcaktohet se nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikativë ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht. Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlen edhe Lote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull.

Ne kemi gjetur se për kontratën kornizë “Mirëmbajtja teknike e objekteve në të gjitha njësitë kërkuese në Komunën e Gjilanit”, në 12 pozicione ka tejkualuar sasinë totale indikative të kontratës kornizë. Në total për këto pozicione për tre vite maksimumi i pagesave do duhej të ishte 40,095€, ndërsa gjatë vitit 2019 janë paguar 191,136€, apo 151,041€ më shumë. Tejkalimi për një pozicion ishte 13,430 njësi, ndërsa pozicionet e tjera kanë tejkualime më numër më të vogël të njërive.

Sipas zyrtarëve përgjegjës kjo kishte ndodhur në mungesë të njohurive se tejkualimi i pozicioneve nuk bën të jetë më shumë se 30%.

Ndikimi

Vlerësimi jo adekuat i nevojave shpie në përsëritjen e procedurave tenderuese, duke shkaktuar shpenzime shtesë të paarsyeshme të parasë publike. Njëkohësisht tejkualimi i vlerave indikativë trevjeçare, në vitin e parë ndikon në rritjen e obligimeve të paplanifikuara.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë që para fillimit të procedurave të prokurimit dhe hyrjes në obligime kontraktuale të jenë të përcaktuara saktë nevojat që do të realizohen përmes kontratave kornizë dhe të sigurojë se menaxherët e kontratës mbajnë shënime adekuate për nivelin e furnizimit të çdo artikulli sipas kontratës kornizë.

Çështja C1 - Mungesa e projektit ekzekutiv të ndërtimit

Gjetja Sipas nenit 28.10 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), definohet qartë se autoriteti kontraktues duhet të posedoj një projekt ekzekutiv të ndërtimit para fillimit të proceduarve të kontraktimit të punëve.

Projekti "Hapja e rrugëve sipas planeve rregulluese" nuk kishte projekt ekzekutiv të ndërtimit. Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës së njësisë kërkuuese lidhur me këtë kërkesë ligjore.

Ndikimi Inicimi i procedurës së prokurimit në mungesë të projektit rezulton me anashkalim të kërkesë ligjore dhe mundëson realizim të dobët të kontratave për punë të pa projektuara, studiuara dhe mund të rezultojë me shpenzime të paparashikuara apo ofrojnë vlerë të dobët për paranë e shpenzuar të taksapaguesit.

Rekomandimi C1 Kryetari të sigurojë se me rastin e kontraktimit të punëve/ndërtimit duhet të sigurohet paraprakisht se nivelet kompetente kanë hartuar projektin në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara në të kundërtën procedurat e tilla nuk duhet të fillojnë.

Çështja B4 - Inicimi i projekteve pa buxhet të mjaftueshëm

Gjetja Sipas Rregullës financiare 01/2013 MF-Për shpenzimin e parasë publike Neni 12, pika 2, kërkohet që para inicimit të një procesi të prokurimit i cili ka për qëllim të rezultojë në ngritjen e një obligimi në vitin aktual fiskal, Organizata Buxhetore (OB) i regjistron të gjitha zotimet e fondeve të ndara në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financiar në Kosovë (SIMFK) në përputhje me rregullat.

Kontrata për projektin "Hapja e rrugëve sipas planeve rregulluese" ishte nënshkruar në vlerë 377,477€, ndërsa zotimi ishte në vlerë prej 9,180€. Sipas Ligjit të Buxhetit për këtë projekt në vitin 2019 ishin paraparë për shpenzim 130,000€, po ashtu edhe kontrata për projektin "Rregullimi/ Asfaltimi i rrugëve në fshatin Livoç i Ulët" ishte nënshkruar në vlerë 466,026€, ndërsa zotimi ishte në vlerë 51,000€. Nuk kemi marrë ndonjë sqarim nga zyra e financave pse nuk është bërë zotimi sa ishte paraparë në Ligj të Buxhetit për këtë projekt.

Ndikimi Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme e rrit rrezikun e vonesave të zbatimit të kontratës dhe rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë ngarkesë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të forcojë kontrollet gjatë zhvillimit të projekteve duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizim.

2.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet dhe investimet kapitale:

Çështja A7 – Vonesa në fillimin e procesit të vlerësimit, vonesa në vlerësim dhe njoftimet për nënshkrimin e Kontratave janë publikuar me vonesë

Gjetja

Sipas “Udhëzuesit operativ për prokurimin publik”, përkatësisht neni 41.2 i këtij udhëzimi: Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve do të kryhet nga Autoriteti Kontraktues brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti me kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Vlerësimi duhet të filloj jo më vonë se 5 ditë pas hapjes së ofertave. Në vijim kemi gjetur:

- Të kategoria e mallrave dhe shërbime kemi gjetur në tre raste nga gjashtë të testuara, se Komuna ka filluar procesin e vlerësimit të tenderit me vonesë. Vonesat janë prej 14 ditëve (Furnizim me lëndë djegëse dru); prej 17 ditëve (Furnizim me material higjieniko sanitar) dhe prej 24 ditëve (Furnizimi me artikuj ushqimor dhe pije).
- Te kategoria e investimeve kapitale në dy procedura të prokurimit ka pasur vonesa në vlerësimin e dosjeve të tenderit, katër ditë te “Ndërtimin e rrugës së Vërbicës së Zhegovcit – Sllovi” dhe 48 ditë te “Ndërtimi i rrugës së Kumanovës faza e II”.

Ndërsa në katër raste tjera Komuna ka publikuar me vonesë Formularin B52 Njoftimi për Nënshkrimin e Kontratës, me vonesë prej 13 ditëve (Furnizimi me artikuj ushqimor dhe pije), 21 ditëve (Furnizim me lëndë djegëse pelet), prej 24 ditëve (Furnizim me lëndë djegëse dru) dhe prej 29 ditëve (Ofrimi i shërbimeve për mbikëqyrjen e projekteve të Komunës së Gjilanit).

Arsyet për këto vonesa nga zyrtarët komunal ishin se zyrtarët janë të angazhuar edhe në detyra të tjera të punës, si dhe për shkak të ankesave të operatorëve ekonomik deri sa të shqyrtohen të njëjtat.

Ndikimi

Vonesat për vlerësimi të ofertave, mund të ndikojnë që fillimi dhe kryerja e punëve për të cilat është zhvilluar aktiviteti i prokurimit të mos përfundojnë me kohë apo edhe të shtyhen për vitin tjetër.

Rekomandimi A7 Kryetari duhet sigurojë se procesi i vlerësimit të tenderëve të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se 5 ditë, vlerësimi të kryhet brenda afateve kohore të parapara, dhe se të gjitha njoftimet dhe dokumentet tjera të kërkuara sipas RRUOPP do të publikohen në kohë.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 215,321,287€, pasurive jokapitale është 1,307,174€, si dhe e stoqeve 197,035€. Kemi testuar 62 mostra për teste substanciale në vlerë 1,604,551€, si dhe kemi bërë teste të pajtueshmërisë.

Çështja A8 – Mbivlerësimi/Nënvlerësimi i pasurisë kapitale

Gjetja

Sipas rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurisë neni 6, pika 3 Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”. Ndërsa neni 13, pika 2, Blerja dhe ndërtimi i pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore përcakton se në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyll llogarinë e investimeve në vijim.

Nga testimi kemi gjetur se komuna ka bërë mbivlerësimin/nënvlerësimi e pasurive kapitale si në vijim:

- Gjashtë pagesa në vlerë prej 92,940€ nuk i ishin regjistruar në regjistrat e pasurisë, këto pagesa i takojnë pasurisë kapitale⁵.
- Komuna kishte pranuar pasuri nga palët e jashtme, në vlerë prej 50,409€. Prej saj vetëm 2,600€, ishin regjistruar si pasuri kapitale, ndërsa pajisjet në vlerë 47,809€ nuk ishin regjistruar në regjistra të pasurisë.
- Pasuritë në vlerë 6,360€ ishin regjistruar tek aplikacioni Excel, si pasuri nën 1,000€ ndërsa kjo pasuri i takon pasurive kapitale.
- Komuna kishte blerë pasuri në vlerë 78,000€, për ndërmarrjen “Tregu”, kjo pasuri ishte regjistruar në regjistra të pasurisë dhe nuk ishte transferuar të kjo ndërmarrje.

⁵•Pagesa në vlerë 50,000€ që ka të bëjë me renovim të objekteve nuk ishte regjistruar e plotë, vetëm vlera 30,250€ ishte regjistruar si pasuri.

•Pagesat në vlerë 27,198€ dhe 30,000€ që janë pjesë e një situacioni të përbashkët e që kanë të bëjnë me sistemin e kamerave në shkollë nuk ishin regjistruar si të plota, vetëm vlera 8,100€ ishte regjistruar si pasuri.

•Pagesa në vlerë 72,636, që ka të bëjë me renovim të objekteve nuk ishte regjistruar e plotë, vetëm vlera 57,636€ ishte regjistruar si pasuri.

•Pagesa në vlerë 3,389€ që ka të bëjë me mbjelljen e drunjëve dhe pagesa në vlerë 5,703€ që ka të bëjë me blerjen e pajisjeve nuk ishin regjistruar fare si pasuri.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve dhe njohurive të kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurisë. Zyrtarët komunal nuk na kanë ofruar shpjegime për rastet e lartcekura.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurisë dhe regjistrimi i gabuar ndikon në mbivlerësim/nënvlerësimin e regjistrit të pasurive, dhe nga kjo rrjedhimisht ndikon që informatat e paraqitura në PFV të mos jenë të sakta.

Rekomandimi A8 Kryetari duhet të sigurojë që artikujt e blerë të regjistrohen në regjistrat përkatës të pasurisë sipas kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurisë. Pasuria e blerë për ndërmarrjen Tregu të largohet nga regjistri i pasurisë së komunës.

Çështja A9 - Mos përdorimi i sistemit e-pasuria dhe mungesa e rregulloreve të brendshme për pasuri

Sipas rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurisë neni 6, pika 3 pasuria nën 1,000€, duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria.

Vlera totale e pasurive jo kapitale nën vlerën 1,000€ në PFV ishte 1,307,174€. Komuna nuk përdorë programin E-pasuria për evidentimin dhe menaxhimin e pasurisë nën 1,000€. Komuna aplikon programin Excel për evidentimin e kësaj pasurie, dhe në këtë program nuk regjistrohen pasuritë sipas vlerës individuale të artikullit, por sipas shumës së transaksionit të ndodhur. Për shkak të mundësisë së manipulimit me të dhëna dhe për shkak se nuk aplikohet zhvlerësimi i pasurisë, vlera e shpalosur e pasurisë në PFV konsiderohet si e pasaktë.

Sipas nenit 4 të rregullores 02/2013, Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtën dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare Komuna nuk ka aprovuar rregulla dhe procedura të brendshme për evidencën ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë të komunës

Zyrtarët komunal nuk na kanë ofruar ndonjë sqarim për mos zbatim të kërkesave të rregullores.

Ndikimi Mos përdorimi i programit E-pasuria për evidentimin dhe menaxhimin e pasurisë mundëson manipulimin me të dhëna e deri te keqpërdorimi i saj dhe rrjedhimisht ndikon në mos prezantim të drejtë të vlerës së pasurisë në PFV. Mos aprovimi i rregullave dhe procedurave të brendshme mund të ndikojë që pasuria të keqpërdoret apo të humbet.

Rekomandimi A9 Kryetari duhet të sigurojë se pasuria nën 1,000€ të regjistrohet në sistemin e-pasuria siç e kërkon rregullorja në fuqi. Gjithashtu duhet të hartojë rregulla dhe procedura të brendshme rreth pasurisë.

2.3 Të arkëtueshmet

Komuna e Gjilanit në Pasqyrat Financiare të saj për vitin 2019, ka paraqitur gjendjen e llogarive të arkëtueshme në vlerë prej 10,792,402€. Kjo shumë përbëhet nga tatimi në pronë 8,665,481€, nga licencat e biznesit 1,760,985€, nga dhënia me qira e pronës komunale 326,580€, nga partneriteti publiko privat 33,404€ si dhe nga inkubatori i bizneseve 5,952€.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 9,951,147€ prej tyre 9,647,779€ janë nga shpronësimet për tokë. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020.

Çështja A10 – Mos protokollimi i faturave dhe vonesa në pagimin e tyre

Gjetja Sipas nenit 24. Pika 1.3 të Rregullës Financiare 01/2013 MF, përcaktohet se fatura duhet të protokollohet/regjistrohet dhe të evidentohet në Librin e Faturave. Ndërsa Neni 37.1 përcakton se të gjitha faturat që i pranon organizata buxhetore duhet të paguhen brenda 30 ditëve në qoftë se nuk është paraparë ndryshe me kontratë.

Ne kemi gjetur se protokollimi i 19 faturave është bërë pas pagesës së tyre, ndërsa 14 fatura janë paguar por ende nuk janë regjistruar. Kjo kishte ndodhur për shkak se komuna nuk ka Libër të Faturave dhe përdor një softuer për protokollimin e faturave, mirëpo nuk ka ndonjë mekanizëm që verifikon saktësinë e tij.

Shtatë fatura në vlerë prej 10,059€, ishin paguar pas skadimit të afatit prej 30 ditë. Arsye e vonesës për pagimin e faturave në afat ishte mungesa e buxhetit.

Ndikimi Mos protokollimi/apo protokollimi i vonshëm i faturave të pranuar paraqet rrezik që faturat të paguhen më shumë se një herë dhe tejkalimi i afatit ligjor për pagesën e obligimeve mund ta bëjë Komunën subjekt të padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/përmbarimore për Komunën.

Rekomandimi A10 Kryetari duhet të sigurojë se bëhet protokollimi/regjistrimi i të gjitha faturave në Librin e Faturave si dhe pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregullore.

Çështja A11 - Mos paraqitja e saktë e vlerës së obligimeve në PFV

Gjetja Sipas Rregullores së MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore të nenit 17, pika 3 kërkohet që Organizatat buxhetore raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues.

Dy fatura në vlerë 5,308€ të cilat i takojnë vitit 2019, nuk ishin paraqitur në pasqyra financiare si obligime, të njëjtat ishin paguar nga ana e Thesarit në vitin 2020. Kjo kishte ndodhur në mungesë të komunikimit në mes të Zyrës së Financave dhe Avokatit të Komunës.

Ndikimi Mos paraqitja e saktë e obligimeve të Komunës, shpie në paraqitjen e shënimeve të gabuara në PFV.

Rekomandimi A11 Kryetari duhet të sigurojë se Avokati i Komunës informon Zyrën e Financave për obligimet që dalin nga vendimet e gjykatës, në mënyrë që raportimi i obligimeve të papaguara të jetë prezantuar drejtë në pasqyra financiare.

2.4.2 Detyrimet kontingjente

Vlera e detyrimeve kontingjente për vitin 2019 ishte vlerësuar 10,936,835€, krahasuar me vitin paraprak vlera ishte rritur për 1,100,542€. Nëse këto padi vendosën në favor të palëve paditëse atëherë, komuna mund të ketë pasoja të rënda financiare.

Çështja A12- Mbivlerësimi i detyrimeve kontingjente

Gjetja Sipas ligjit për menaxhimin e financave publike nr.03-L-048, “Detyrim Kontingjent” - do të thotë një detyrim i cili materializohet vetëm pas ndodhjes së disa ngjarjeve të caktuara në të ardhmen.

Komuna kishte paraqitur në PFV, vlerën prej 33,246€ si detyrim kontingjent, dhe si detyrim të paguar. Ky lloj detyrimi përket detyrimeve të papaguara. Nuk kemi ndonjë shpjegim për këtë nga ana e zyrtarëve komunal.

Ndikimi Paraqitja e shënimeve të njëjta në dy kategori të ndryshme në PFV, ndikon në mbivlerësimin e detyrimeve kontingjente si dhe dhënien e informatave jo të sakta për shfrytëzuesit e të PFV-ve.

Rekomandimi A12 Kryetari duhet të sigurojë se prezantimi i detyrimeve bëhet saktë sipas kërkesave të ligjit për menaxhimin e financave publike.

2.4.3 Detyrimet kontraktuale

Pasqyra e detyrimeve kontraktuale ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, nuk është ofruar nga Komuna e Gjilanit. Këto detyrime janë për kontratat/marrëveshjet e nënshkruara për të cilat obligimet paguhen në vitet në vijim.

2.5 Funksioni i auditimit të brendshëm

Komuna e Gjilanit ka të themeluar Njësine e Auditimit të Brendshëm (NJAB) e cila operon me tre auditorë, ku njëri është Drejtor i Njesisë së Auditimit të Brendshëm. NJAB kishte hartuar planin strategjik për periudhën 2019-2021 dhe planin vjetor për Vitin 2019. NJAB ka përmbushur planin vjetor duke kryer 12 auditimet planifikuara, nga auditimet e kryera kishin rezultuar 24 rekomandime, nga të cilat 13 ishin zbatuar, shtatë ishin në proces të zbatimit dhe katër rekomandime të pazbatuara. Komiteti i auditimit gjatë vitit 2019 kishte mbajtur katër takime.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 të Komunës së Gjilanit ka rezultuar në 18 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna. Komuna ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve me (30 shtator dhe 15 mars) sipas kërkesave të dala nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, 10 rekomandime janë zbatuar, një ishte në proces, katër nuk janë zbatuar, dhe tri konsiderohen të mbyllura. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve)

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

N r.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për theksimin e çështjes. Të gjitha shpenzimet duhet të paguhen dhe evidentohen në përputhje me planin kontabël, bazuar në kërkesat e ligjit të buxhetit. Më tutje të forcohen kontrollet në evidentimin e të gjithë pasurisë si dhe obligimeve të papaguara dhe të shpalosen drejt në pasqyrat financiare duke u mbështetur me dokumentacion përkatës. Duhet të ndërmerren veprime specifike për çështjeje tjera të ngritura lidhur me PVF, për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të eliminuar gabimet në raportimin e PVF-ve, përfshirë edhe shpalosjen e drejtë. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Kjo e gjetur është bartur tek kategoritë përkatëse. Andaj këtu konsiderohet e mbyllur.	Rekomandimi i mbyllur
2	Procesi buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një vlerësim sistematik të shkaqeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit të investimeve kapitale dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij në vitin e ardhshëm.	Kjo çështje nuk do të trajtohet në raportin e auditimit të vitit 2019.	Rekomandimi i mbyllur
3	Të hyrat	Kryetari duhet të kërkojë nga menaxheri i tatimit në pronë që gjatë procesit regjistrimit dhe verifikimit të pronave ti kushtohet kujdes jo vetëm regjistrimit të pronave të reja dhe ndryshimeve fizike që ndodhin në pronat ekzistuese dhe por edhe korrigjimet e dobësive të identifikuar të cilat kanë të bëjnë me informatat e pronave të tatimpaguesve në sistem, në mënyrë që përllogaritjet e ngarkesave tatimore të jenë sa më reale.	Komuna ka ndërmarrë veprime në korrigjimet e dobësive të identifikuar .	Rekomandimi i zbatuar
4	Të hyrat	Kryetari duhet të kërkojë nga Zyra e Tatimit në Pronë një plan të detajuar afatmesëm për të eliminuar dobësitë e identifikuar, dhe ta mbikëqyrë në baza të rregullta zbatimin e atij plani duke mundësuar eliminimin e dobësive të identifikuar.	Ekipi i auditimit nuk ka identifikuar ndonjë rast të tillë.	Rekomandimi i zbatuar

5	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurohet që prona e paluajtshme e komunës të shfrytëzohet në mënyrë efektive duke pasur parasysh respektimin e kërkesave ligjore me të cilin përcaktohen procedurat dhe format për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.	Gjendja vazhdon të jetë e njëjtë. Çështja B1	Rekomandimi i pazbatuar
6	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet që të planifikoj buxhet mjaftueshëm për pagesën e të gjithë punonjësve sipas akt emërimeve të vlefshme që kanë punonjësit në mënyrë që komuna t'iu shmanget padive të ndryshme dhe shpenzimeve të mundshme shtesë të procedurave gjyqësore apo të filloj dhe zbatoj procedurën administrative për harmonizimin e Akt emërimeve.	Komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim. Referoju çështjes B2	Rekomandimi i pazbatuar
7	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e pagesave për tu siguruar se pagesat do të realizohen vetëm pas ofrimit të dëshmimeve të mjaftueshme për kryerjen e punëve/shërbimeve të kontraktuara dhe në përputhje me kushtet e kontraktuara. Gjithashtu, merren masa për ndalimin e praktikës së parregullt të pagesave për transportin e nxënësve duke kompensuar edhe demin buxhetor nga përgjegjësit.	Ekipi i auditimit nuk ka identifikuar ndonjë rast të tillë	Rekomandimi i zbatuar
8	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari të siguroj funksionim efikas tek kontrollet e menaxhimit të kontratave. Menaxherët e kontratës mbajnë shënime adekuate përnivelin e furnizimit të çdo artikulli me kontratë kornizë, në mënyrë që furnizimet bëhen në pajtim me sasi të vlerën e kontraktuar dhe komuna nuk porosit furnizime më shumë se është e lejuar me kontratë dhe me LPP, sikurse duhet të siguroj që është bërë planifikim real i nevojave.	Komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim. Shih Çështjen B3	Rekomandimi i pazbatuar
9	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari të sigurohet se kontrollet brenda Zyrës së Prokurimit funksionojnë që para se të publikohen dosjet e tenderit të bëhet edhe një rishikim formal i dosjes së tenderit nga zyrtari përgjegjës në mënyrë që të shmangen gabimet e tilla.	Ekipi i auditimit nuk ka identifikuar ndonjë rast të tillë	Rekomandimi i zbatuar

10	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari me menaxhmentin e komunës duhet t'i rishikojë nevojat reale për angazhim të punëtorëve me kontrata për shërbime të veçanta, pasi që rastet e vërejtura nuk kanë të bëjnë me shërbime të veçanta apo kalimtare por janë pozita të përhershme. Nevoja për staf shtesë për pozitat e karrierës duhet të analizohet dhe nëse rritja e numrit të stafit është e domosdoshme, kjo të inkorporohet edhe në planifikimet buxhetore.	Ekipi i auditimit nuk ka identifikuar ndonjë rast të tillë	Rekomandim i zbatuar
11	Subvencione dhe transfere	Kryetari të siguroj që me rastin e ndarjes së subvencioneve është lidhur marrëveshja përkatëse dhe përfituesit raportojnë për zbatimin e projektit.	Komuna kishte bërë thirrje publike.	Rekomandim i zbatuar
12	Subvencione dhe transfere	Kryetari, duhet të siguroj që pagesat për subvencione të jenë në harmoni me rregulloren e brendshme për ndarjen e subvencioneve, vendimet dhe marrëveshjet për subvencionim si dhe se pagesat nga kjo kategori të bëhen vetëm përfitueseve.	Ekipi i auditimit nuk ka identifikuar ndonjë rast të tillë	Rekomandim i zbatuar
13	Subvencione dhe transfere	Kryetari, duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet në procesin e ndarjes së subvencioneve, dhe se përfituesit i plotësojnë kriteret në bazë të cilave është lejuar subvencioni bazuar në rregullore.	Komuna kishte bërë shpallje publike për subvencionim	Rekomandim i zbatuar
14	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë respektimin konsistentë dhe efektiv të rregullave të prokurimit, në lidhje me menaxhimin e kontratave. Gjithashtu edhe kuvendi duhet të veprojë në bazë të kompetencave me qëllim të respektimit të rregullave dhe mos tejkalimit të kompetencave.	Gjatë auditimit nuk kemi hasur në ndonjë rast të tillë.	Rekomandim i zbatuar
15	Investimet kapitale	Kryetari të siguroj kontrolle dhe monitoroj zbatueshmërinë e kërkesave ligjore duke rishikuar implementimin e ligjit të prokurimit. Me rastin e kontraktimit të punëve/ndërtimit duhet të sigurohet paraprakisht se nivelet kompetente kanë hartuar projektin në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara në rast të kundërt procedurat e tilla nuk duhet të fillojnë.	Komuna ka marrë veprime, ku nga pesë projekte të testuara vetëm një nuk kishte projekt detal shih C1.	Rekomandim në proces të zbatimit

16	Investimet kapitale	Kryetari duhet të forcoj kontrollet gjatë zhvillimit të projekteve duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizim.	Nga pesë kontrata të testuara dy ishin lidhur pa buxhet të mjaftueshëm. Referoju çështjes B4.	Rekomandimi i pazbatuar.
17	Të arkëtueshme	Kryetari të siguroj një menaxhim efektiv të kontratave të qiradhënies dhe të vendos mekanizma efikas për realizimin e të hyrave në pajtim me kushtet e kontraktuara, përkatësisht zbatimin e afateve për faturimin dhe arkëtimin e mjeteve nga qiraja.	Komuna ka filluar të dërgoj padi në Gjykatë për borxhlinjtë, dhe ka rritur arkëtimin e borxheve.	Rekomandimi i zbatuar
18	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari, duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, plani i prokurimit, menaxhimi i pasurisë dhe menaxhimi i llogarive të arkëtueshme, duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit.	Zyra Kombëtare e Auditimit në raportin e auditimit për vitin 2019 nuk ka trajtuar këtë kapitull.	Rekomandimi i mbyllur
N r.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari i duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që të shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestitim i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.		
2	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurohet që prona e paluajtshme e komunës të shfrytëzohet në mënyrë efektive duke pasur parasysh respektimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.		
3	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet që të planifikojë buxhet të mjaftueshëm dhe në bashkëpunim me Thesarin të filloj pagesat e pagave sipas kontratave të nënshkruara.		
4	Subvencione dhe transfere	Kryetari duhet të sigurojë se përgatitet Plani Vjetor për Mbështetje Financiare për OJQ-të dhe të sigurojë se i njëjti përmban të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregullore për Mbështetje Financiare.		
5	Subvencione dhe transfere	Kryetari duhet të sigurojë se subvencionet do të jepen në pajtim me Rregulloren e Komunës, ku një fermer nuk mund të jetë përfitues më shumë se një herë brenda vitit. Përndryshe të shqyrtohet mundësia e ndryshimplotësimit të rregullores për dhënie të subvencioneve.		

6	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që me rastin e vlerësimit të krijohen kapacitete të mjaftueshme teknike të vlerësimit dhe të shpërblehen operatorët ekonomik të cilët i plotësojnë më së miri kërkesat e dosjes së tenderit.
7	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se për çdo kontratë të nënshkruar të emërohet menaxheri i projektit, pavarësisht faktit se Komuna ka organ mbikëqyrës.
8	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se aplikohen të gjitha procedurat dhe rregullat e prokurimit publik, sa i përket ndarjes së drejtë të detyrave gjatë procesit të prokurimit, për shmangien e çfarëdo konfliktit të mundshëm të interesit.
9	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që para fillimit të procedurave të prokurimit dhe hyrjes në obligime kontraktuale të jenë të përcaktuara saktë nevojat që do të realizohen përmes kontratave kornizë dhe të sigurojë se menaxherët e kontratës mbajnë shënime adekuate për nivelin e furnizimit të çdo artikulli sipas kontratës kornizë.
10	Investimet kapitale	Kryetari të sigurojë se me rastin e kontraktimit të punëve/ndërtimit duhet të sigurohet paraprakisht se nivelet kompetente kanë hartuar projektin në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara në të kundërtën procedurat e tilla nuk duhet të fillojnë.
11	Investimet kapitale	Kryetari duhet të forcojë kontrollin gjatë zhvillimit të projekteve duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizim.
12	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale	Kryetari duhet sigurojë se procesi i vlerësimit të tenderëve të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se 5 ditë, vlerësimi të kryhet brenda afateve kohore të parapara, dhe se të gjitha njoftimet dhe dokumentet tjera të kërkuara sipas RRUOPP do të publikohen në kohë.
13	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Kryetari duhet të sigurojë që artikujt e blerë të regjistrohen në regjistrat përkatës të pasurisë sipas kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurisë. Pasuria e blerë për ndërmarrjen Tregu të largohet nga regjistri i pasurisë së komunës.
14	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Kryetari duhet të sigurojë se pasuria nën 1,000€ të regjistrohet në sistemin e-pasuria siç e kërkon rregullorja në fuqi. Gjithashtu duhet të hartojë rregulla dhe procedura të brendshme rreth pasurisë.
15	Detyrimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se bëhet protokollimi/regjistrimi i të gjitha faturave në Librin e Faturave si dhe pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregullore.
16	Detyrimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se Avokati i Komunës informon Zyrën e Financave për obligimet që dalin nga vendimet e gjykatës, në mënyrë që raportimi i obligimeve të papaguara të jetë prezantuar drejtë në pasqyra financiare.
17	Detyrimet kontigjente	Kryetari duhet të sigurojë se prezantimi i detyrimeve bëhet saktë sipas kërkesave të ligjit për menaxhimin e financave publike.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër e Konfirmimit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2019 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Gjiçanit, për vitin 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Lutfi Haziri

Kryetar i Komunës së Gjiçanit

Data: 29.06.2020, Gjiçan

Lutfi E. Haziri

